

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Nr. 02-38/26-06

Prishtinë, më 20 dhjetor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 82 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë,
9. Shqyrtimi i propozimvendimit për ridestinimin e mjeteve të Ministrisë së Punë dhe Mirëqenie Sociale.

**Kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

Ai në fillim të seancës i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare për t'u konsultuar lidhur me procedimin e rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kuvendi miratoi rendin e ditës, të propozuar nga Kryesia.

### **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Ferid Agani** pyeti kryeministrin e Kosovës, z Agim Çeku, lidhur me përgjegjësinë e Qeverisë dhe të ministrit të Shëndetësisë për moszbatimin e Ligjit për shëndetësi.

Kryeministri **Çeku** iu përgjigjur deputetit Agani.

### **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007**

**Kryetari** e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ta paraqesë raportin e këtij komisioni lidhur me Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2007.

**Naser Osmani**, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se Komisioni ka shqyrtuar në hollësi Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2007, për të cilin ka përgatitur raportin me amendamentet. Komisioni i propozon Kuvendit ta miratojë këtë projektligj me amendamente, si dhe buxhetet e zyrave dhe të agjencive të pavarura.

**Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se e mbështet raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për buxhetin e vendit për vitin 2007.

**Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së i kundërshtoi Projektligjin dhe raportin e Komisionit FunkSIONAL për buxhetin e Kosovës për vitin 2007, duke e arsyetuar se ai nuk është në funksion të zhvillimit të vendit.

Ai tha se Grupi Parlamentar i PDK-së nuk do të marrë pjesë në votimin e këtij projektligji.

**Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se i mbështet Projektligjin dhe raportin e Komisionit FunkSIONAL për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

**Teutë Sahatçiu**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s kërkoi të rishqyrtohen prioritetet për caktimin e mjeteve në Projektligjin për buxhetin e vendit për vitin 2007.

**Ferid Agani**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, tha se raporti i Komisionit FunkSIONAL nuk i ka përfshirë vërejtjet e tyre. Ai kërkoi të shtyhet miratimi i këtij projektligji dhe të bëhet leximi i tretë.

**Husnija Beshkoviq**, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, tha se i mbështet projektligjin dhe raportin e Komisionit Funkcional për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjin dhe raportin e Komisionit Funkcional për buxhetin e Kosovës për vitin 2007 dhanë edhe këta deputetë: **Nazim Jashari, Safete Hadërgjonaj, Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Fatmire Kollçaku, Hydajet Hyseni, Enver Hoxha, Besa Gaxheri, Bujar Dugolli, Genc Gorani, Behxhet Brajshori, Emrush Xhemajli, Gjergj Dedaj, Ymer Muhaxheri, Fatmir Rexhepi, Sabri Hamiti, Ramadan kelmendi, Nekibe Kelmendi, Bajram Kosumi, Kamber Kamberi, si dhe ministrat: Haki Shatri, Bujar Dugolli dhe Ardian Gjini**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në mungesë të kuorumit për ta miratuar Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2007, **kryetari** i mbylli punimet e seancës së sotme dhe caktoi datën 23 dhjetor ( e shtunë) për miratimin e këtij projektligji.

E premte, 22 dhjetor 2006  
**Vazhdim i seancës**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----59;  
Kundër----- 2.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për mbrojtjen e bimëve.

#### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht të gjirit**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----60;

Kundër----- 2.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht të gjirit.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse**

**Kryesuesi** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Sadik Idriz**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Idrizi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, si dhe mënyrën e zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Idrizi**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fehmi Vula, Florë Brovina, Zylfije Hundozi, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku dhe Shpresa Murati**, që i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 62;

Kundër----- 0.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi në parim Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për inspektoratin e punës**

**Kryesuesi** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës.

Në vazhdim, ministri **Selmanaj** shpjegoi pengesat që kishin hasur gjatë zbatimit të këtij projektligji, si dhe mënyrat për tejkalimin e tyre.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Selmanaj**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ilaz Pireva, Florë Brovina, Zylfije Hundozi, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Ramadan kelmendi, zahrije Jusufi dhe Sevdije Halimi**, që i janë bashkangjitur trasnkriptitit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 41;

Kundër----- 25.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

## **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik**

**Kryesuesi** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Behxhet Brajshori**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik.

Në vazhdim, zëvendësministri **Brashori** shpjegoi pengesat që kishin hasur gjatë zbatimit të këtij projektligji, si dhe propozimet për tejkalimin e tyre.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Brashori**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nerxhivane Dauti, Mazllom Kumnova, Nazim Jashari dhe Nuran Malta**, që i janë bashkangjitur trasnkriptitit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 56;

Kundër----- -1.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

## **9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ridestininimin e mjeteve të Ministrisë së Punës dhe Të Mirëqenies Sociale**

**Kuvendi**, me propozim të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për lejimin e transferit të mjeteve të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, mori këtë

### **V E N D I M**

1. Lejohet transferi i mjeteve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere - Kodi (Programi i lehonave 010) në të njëjtën kategori ekonomike në shumë prej 786,322 Euro.
  - a). në kodin (Programi i pensioneve bazike 001) në shumë prej 512,186 Euro,
  - b) në kodin (Programi i pensioneve me paaftësi 002) në shumë prej 127,746 Euro,
  - c) në kodin (Programi i pensioneve të Trepçës 004) në shumë prej 135,390 Euro,
  - d) në kodin (Programi i Divizionit të Punësimit 431) në shumë prej 11,000 Euro,
2. Lejohet transferi i mjeteve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere - Kodi (Programi shërbimet sociale 006) shuma 1,299,838 Euro.
  - a). në kodin (Programi i skemës së asistencës 005) në shumë prej 1, 185,490 Euro,
  - b). në kodin ( Programi i personave me paaftësi 002) në shumë prej 114,348 €,
3. Lejohet transferi i mjeteve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga Kodi ( Programi i invalidëve të luftës 003) në shumë prej 767,636 €
  - a). Në kodin (Programi i pensioneve me paaftësi 002) në shumë prej 767,636 €.

E shtunë, 23 dhjetor 2006  
Salla e seancave plenare, në orën 10:00  
**Vazhdim i seancës**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Të pranishëm ishin 72 deputetë.

### **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 2007**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Naser Osmani**, sqaroi se së bashku me Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2007, amendamentet e miratuara, duhet të miratohen - në paketë - edhe buxhetet e agjencive të pavarura.

Pastaj, **kryetari** i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi, si dhe projektbuxhetet e agjencive të pavarura. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----65;  
Kundër----- 7.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 2007.

**Kryetari** seancën e deklaroi të mbyllur në orën 10:45minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**